



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 145, Datë 28. 08. 2020**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS TIP TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR PËR KLIENTËT FUNDORË QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI PUBLIK I FURNIZIMIT”.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe neneve 75, 89, 92, 93 dhe 94 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, si dhe nenit 26 të "Rregullores të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.08.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/4 Prot, datë 26.08.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftit që parashikon kushtet e përgjithshme të Kontratës Tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit.

Konstatoi:

- Në përmbushje të detyrimeve që cakton Ligji Nr. 102/2015 “ Për Sektorin e Gazit Natyror”, parashikuar në nenin 16, pika 10, neneve 92, 93, pika 1 ERE miraton kushtet e përgjithshme të furnizimit për klientët fundorë, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme, në shërbimin e furnizimit të ofruar nga të Licensuarit në aktivitetin e furnizimit publik në Sektorin e Gazit Natyror.
- Dispozitat e kontratës së furnizimit me gaz natyror duhet të jenë të drejta, proporcionale, të qarta dhe të kuptueshme, dhe duhet të aplikohen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.
- Në këtë rregullore përcaktohet se Kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të kenë pengesa në ushtrimin e të drejtave të klientit fundorë dhe nuk duhet të paraqesin metoda të padrejta ose ç’orientuese të shitjes, matjes, faturimit dhe/ose pagesës.
- Kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të përmbajnë dispozita që mund të parandalojnë ose pengojnë klientin nga ndërprerja e njëanshme e kontratës, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këto Rregulla dhe/ose ndryshimi pa pagesë i furnizuesit sipas rregullave të ndryshimit të furnizuesit, të miratuara nga ERE.

- Drafti me kushtet e përgjithshme të kontrates tip të furnizimit me gaz natyror për klientin fundor që përfiton nga shërbimi publik i furnizimit, është hartuar në mbështetje të neneve 75, 89, 92, 93, 94, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, gjithashtu dhe Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Drafti i kushteve të përgjithshme të Kontratës Tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit, do të konsultohet me palët e interesit, përpara miratimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kushteve të përgjithshme të Kontratës Tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**